



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 8, paragrafi 8.1 dhe nenit 20, paragrafi 20.1, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi 632-23-1919-2-2-1, numër të brendshëm 632-23-017-221 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-10509, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 04.03.2025, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

Neni 8, i KPK përcakton se “Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi”;

Neni 20 paragrafi 20.1 i KPK përcakton se “Palët duhet t’i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën”

Me dt.03.03.2025, Menaxheri i kontratës i është drejtuar Zyrës së Prokurimit, me kërkesë për shkëputjen me marrëveshje të kontratës "Pastrimi dhe larja e veturave zyrtare-Kontratë dy vjeçare", e lidhur me dt.23.05.2023, me numër te prokurimit: 632-23-1919-2-2-1, numër të brendshëm 632-23-017-221 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-10509;

Sipas Menaxherit të kontratës kontrata " Pastrimi dhe larja e veturave zyrtare-Kontratë dy vjeçare", për arsye shëndetësore të kryesit të shërbimeve Lirak Bordoniqi B.I., është e pamundur të vazhdohet.

Andaj, bazuar në nenin 8, paragrafi 8.1 dhe nenin 20, paragrafi 20.1 të KPK, si dhe kërkesën e dt.03.03.2025, të menaxherit të kontratës, do të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

Nga sa u tha më lartë, ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 23.05.2023, me numër te prokurimit : 632-23-1919-2-2-1, numër të brendshëm 632-23-017-221 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-10509, me titull " : Pastrimi dhe larja e veturave zyrtare-Kontratë dy vjeçare", ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të shërbimeve Lirak Bordoniqi B.I., rr."Mark Malota" nr.7, Gjakovë, do te ndërpritet me marrëveshje mes dy palëve me date 05.03.2025.

Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

Shkresës i bashkëngjiten kërkesa e Operatorit ekonomik dhe rekomandimi i Menaxherit të kontratës për shkëputje të kontratës.

Me respekt,

Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE/A:	03.03.2025
PËR:	z. Faton Gutaj , Menaxher i Prokurimit, Komuna Gjakovë
PËRMES:	z. Kosovar Alija, Drejtor i Administratës, Komuna Gjakovë
NGA:	Menaxheri i projektit- z. Lulzim Tertini
CC:	z. Adian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Kërkesë për shkëputje me marrëveshje të kontratës me titull: "Pastrimi dhe larja e veturave zyrtare", kontratë dy vjeçare.

Të nderuar,

Kontrata kanë filluar 23.05.2023, OE nënshkrues i kontratës Lirak Bordoniqi ka bërë një kërkesë me shkrim duke paraqitur shqetësimin e tij që për arsye shëndetësore nuk mund ta vazhdojë me kontratë (gjegjësisht larjen e automjeteve të Komunës së Gjakovës.

Andaj kërkoj që Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovë ta mirëkuptoj, dhe të bëj shkëputjen e Kontratës "Pastrimi dhe larja e veturave zyrtare, kontratë dy vjeçare", në mënyrë miqësore.

Ju rekomandoj që të vazhdoni me procedurat për shkëputjen e Kontratës.

Me Respekt,
Lulzim Tertini
Menaxher i kontratës

Kërkesë



I nderuar z. Tertini, ju njoftoj se për arsye shëndetësore e kam të pamundur të zhvilloj veprimtarinë me tutje me kontratën **"Pastrimi dhe larja e veturave zyrtare"**, andaj kërkoj me mirëkuptim të bëhet shkëputja e kësaj kontrate.

Duke shpresuar qe kërkesa ime të mirëkuptohet,

Me respekt,

Lirak Bordoniqi B.I. Artist Estrade 811146168 Gjakovë.